

GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT,
SEZONI 2023/2024
(java e parë, deri më 07.01.2024)

TË DHËNA JAVORE


Gjatë javës së parë të vitit 2024 (nga 01-07.01.2024), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 1.025 ($I=55,8/100.000$) të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, që është për 2,5 herë më shumë krahasuar me javën e kaluar ($n=403$).

Krahasuar me javën e njëjtë të sezonit ta kaluar ($n=821$) është regjistruar një rritje prej 24,8%, ndërsa në raport me modelin për 13 sezonet e fundit ($n=607$) është regjistruar një rritje prej 68,8% . (*Grafiku 1*)

Gjatë javës së parë të vitit 2024, pranë laboratorit të virusologjisë të ISHPRMV kanë arritur 37 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuar edhe për grip edhe për COVID-19. 21 raste kanë rezultuar pozitive për Influenza 19 A(H1)pdm09 dhe nga 1 Influenza A(H3) dhe Influenza A – e pasubtipizuar. Është regjistruar një rast me COVID-19 dhe një me virus sincicial respirator (RSV).

Incidenca e raportuar për herë të parë është mbi kufirin javor të aktivitetit sezonal të virusit të gripit ($I=30,6/100.000$), pra është arritur pragu i hyrjes në sezonin e gripit (*Grafiku 1*).

Grafiku 1. Intensiteti dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemiologjike të pritur 2010-2023, sezoni 2022/2023 dhe sezoni 2023/2024




Sa i përket moshës, tek grupmosha 15-64 janë regjistruar 544 persona, nga 0-4 vjet – 165, tek grupmosha nga 5-14 – 43 dhe tek grupmosha mbi 65 vjet 63 persona. Incidencë më e lartë (191,7/100.000) është regjistruar tek grupmosha nga 0-4 vjet.

Të sëmurët e kësaj jave janë raportuar nga 18 QShP/NjR: Shkup – 269, Dibër – 188, Gostivar – 114, Shtip – 107, Manastir – 104, ndërsa në të tjerat numri i rasteve të raportuara është më pak se 100.

Nga 8 njësi raportimi që kanë raportuar raste gjatë kësaj jave është regjistruar aktivitet shumë i ulët i virusit të gripit, në 6 sezonal, në tre mesatar, ndërsa në 1 (Dibër) – aktivitet i lartë (*Hartogrami 1*).

Hartogrami 1. Niveli i aktivitetit të gripit sipas incidencës në 100.000 banorë, jave e parë 2024



МБИКЉРЈА ЕПИДЕМИОЛОГИЈЕ - Тë дhëна кумулативе

Gjatë sezonit 2023/2024 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është 2.318 ($I=126,2/100.000$).

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar ($n=1.751$) numri i rasteve të regjistruara është rritur për 32,4%, ndërsa krahasuar me modelin e 13 viteve të fundit ($n=1.685$) është regjistruar një rënie prej 37,6%.

Raste janë raportuar nga gjithsej 23 QShP/NjR. Numër më i madh i të sëmurëve (722) dhe incidencë më e lartë kumulative ($3.773,8/100.000$) është regjistruar në Dibër.

Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numër më i madh i të sëmurëve janë regjistruar në grupmoshën e cila përfshin pjesën më të madhe të popullatës (15-64 vjet) – 1.105 (47,7%), ndërsa incidencë më e lartë (517,0/100.000) është regjistruar tek fëmijët në moshë nga 0-4 vjet (n=499).

Shpërndarja e rasteve të gripit sipas muajve:

- tetor – 196 raste ose 8,5%
- nëntor – 268 raste ose 11,6%
- dhjetor – 221 raste ose 35,7%
- janar - 1.025 raste ose 44,2%

Deri më tani gjatë këtij sezoni janë regjistruar 2 raste të vdekjes si pasojë e gripit, nga Shtipi dhe Shkupi, të grupmoshës mbi 65 vjet, të dy rastet e hospitalizuar, me komorbiditete dhe të pavaksinuar kundër gripit sezonal. Tek të dy rastet është vërtetuar Influenza A(H1)pdm09.

MBIKËQYRJA VIRUSOLOGJIKE (mbikëqyrja rutinore) – Të dhëna kumulative

Nga fillimi i sezonit 2023/2024, deri në javën e parë, pranë laboratorit të virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 466 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për prani të virusit të gripit, nga mbikëqyrja rutinore.

Të gjitha materialet e pranuar janë testuar për prani të virusit të gripit dhe SARS-CoV-2, me ç'rast janë detektuar 34 raste pozitive, 29 Influenza A(H1)pdm09, 4 Influenza A(H3) dhe 1 Influenza A – e pasubtipizuar.

Janë regjistruar edhe 5 raste pozitive me SARS-CoV-2.

Janë regjistruar 21 raste me Virus Respirator Sincial (RSV).

MBIKËQYRJA SENTINEL NDAJ SARI (Infeksioneve Respiratore Akute Serioze)

Mbikëqyrja sentinel zbatohet si shtesë e sistemit të rregullt të mbikëqyrjes ndaj gripit dhe COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim që të fitohet informacion më i detajuar për incidencën, intensitetin, llojin e viruseve që qarkullojnë dhe për implementimin në kohë të masave preventive.

Definicioni për rast SARI sipas të cilës zbatohet mbikëqyrja është e harmonizuar me definicionin e rastit nga OBSH-ja që nga viti 2014.

Në vendet sentinel gjatë javës së parë janë raportuar gjithsej 56 raste SARI, nga vendet sentinel SARI në Shkup dhe në Shtip. Numri më i madh i rasteve SARI është raportuar nga Klinika e sëmundjeve infektive

dhe gjendjeve febrile - Shkup (n=17; 30,4%). Ndërsa sa i përket moshës, numri më i madh i rasteve SARI (n=23; 41,1%) janë raportuar në mesin e grupmoshës 0-4 vjet.

Gjatë kësaj jave numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 207, me 2 rast në kujdesin intensiv. Nga të gjitha pranimet, 27,1% i përkasin SARI. Ngarkesë më e madhe prej 40,0% vihet re tek grupmosha 15-29 vjet.

Kumulativisht gjatë javës së parë për analizë laboratorike kanë arritur 31 materiale nga rastet e raportuara SARI, paralelisht të testuara edhe për virusin e gripit, virusin sincicial respirator edhe për COVID-19. Në 20 mostrat e analizuara tek 9 është vërtetuar prani e virusit të gripit Influenza A(H1)pdm09, në 2 mostra është vërtetuar COVID-19, ndërsa në 2 mostra virusi sincicial respirator.

Kumulativisht, nga të gjitha vendet sentinel, janë raportuar gjithsej 507 raste SARI. Numri më i madh i rasteve SARI (n=173; 34,1%) janë raportuar nga Klinika e sëmundjeve të fëmijëve Shkup. Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numri më i madh i rasteve SARI është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet (n=266; 52,5%).

Kumulativisht numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 2.749, nga të cilët 19 persona janë në kujdes intensiv. Nga të gjitha pranimet, 18,4% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e madhe prej 35,8% vihet re tek grupmosha mbi 65 vjet.

Janë regjistruar edhe 2 raste të vdekjes i raportuar nga SK në Shtip, që i përkasin grupmoshës mbi 65 vjet, pa komorbiditete dhe njëri pozitiv për COVID-19, ndërsa tjetri për Influenza A(H1)pdm09.

Kumulativisht, për testim laboratorik janë dorëzuar 253 materiale nga rastet e raportuara SARI. Në 19 mostra është vërtetuar Influenza A(H1)pdm09, në 1 Influenza A(H3) dhe në 1 Influenza B. Janë regjistruar 16 raste pozitive me COVID-19. Nga mostrat SARI, 207 u testuan për virusin respirator sincicial (RSV), nga të cilët 92 rezultuan pozitivë.

Adenovirusi u zbulua në 5 mostra dhe Enterovirus në një. Në 2 mostra është verëtuar prania e njëkohshme e virusit sincicial respirator (RSV) dhe adenovirusit.

MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE


Nga fillimi i sezonit 2023/2024, deri në javën e parë të vitit 2024, pranë laboratorit të virologjisë në ISHP kanë arritur 719 materiale, që janë testuar për prani të virusit të influencës dhe SARS-CoV-2.

Janë zbuluar 55 raste me Influenza:

- 48 Influenza A(H1)pdm09,
- 5 Influenza A(H3),
- 1 Influenza A – e pasubtipizuar dhe
- 1 Influenza B.

Janë regjistruar 21 raste pozitive me SARS-CoV-2, 115 me (RSV) dhe 10 me viruse të tjerë respiratorë.

Grafiku 2. Shpërndarja javore e numrit dhe përqindjes së rasteve pozitive me grip, RMV, 2023/2024



KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Vihet re një rritje e numrit të sëmundjeve të ngjashme me gripin, i cili për herë të parë këtë sezon është mbi kufirin javor për aktivitetin sezonal. Rezultatet e marra nga mbikëqyrja virologjike e gripit tregojnë aktivitet të dherë të virusit të influencës. Sipas këtyre të dhënave, Republika e Maqedonisë së Veriut ka një përhapje të gjerë gjeografike intensitet të lartë të virusit të gripit.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i Shëndetit Publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- ❖ Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- ❖ Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- ❖ Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- ❖ Gratë shtatzëna dhe
- ❖ Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2023 /2024, Ministria e Shëndetësisë siguroi 60.000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 15.000 doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Më datën 25.10.2023 filloi vaksinimi kundër gripit sezonal. Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2023/2024 do të zbatohet në Shtëpitë e Shëndetit dhe/ose Qendrat e Shëndetit Publik me Njësitë e tyre Rajonale. Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vaksinacija.mk.

Sipas Drejtorisë për shëndetësi elektronike që nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti janë vaknuar gjithsej 58.287 persona nga kategoritë e rrezikuara të qytetarëve.

4.500 vakcina shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të Shëndetit Publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre Rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale deri më tani janë vaksinuar gjithsej 2.479 persona.

Deri në javën e parë në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 60.766 persona me vaksinat falas dhe komerciale.

RAJONI EVROPIAN

Sipas Raportit të ERVISS (European Respiratory Virus Surveillance Summary) të publikuar në javën e 52 të vitit 2023 për aktivitetin e virusit të gripit në Rajonin Evropian të OBSH-së:

- Shkalla e sëmundjeve të ngjashme me gripin (ILI) dhe/ose infeksionet akute të frymëmarrjes (ARI) janë rritur mbi nivelet bazë në 11 nga 27 vendet dhe zonat e Rajonit Evropian të OBSH-së.
- Aktiviteti i gripit vazhdon të rritet, aktiviteti i COVID-19 mbetet stabil, ndërsa i RSV ka filluar të bjerë.
- Pranimet në spital (SARI) me grip dhe RSV janë në rritje.
- Zbulimet e vërtetuara të infeksionit me virusin e influencës nga ISHP sentinel për javën e kaluar ishin Influenza A (98%) - A(H1)pdm09 (69%) dhe A(H3) (31%).
- Në të gjithë rajonin, nga mostrat e pacientëve nga mbikëyrja SARI:
- Shkalla e zbulimit të virusit të gripit është rritur në 28% krahasuar me 24% një javë më parë. Pozitiviteti mesatar ishte 10% .
- SARS-CoV-2 është në 10% krahasuar me 5% javën e kaluar. Pozitiviteti mesatar i vendit ishte 9% (shtrirja: 0–28%).
- RSV ishte 17% krahasuar me 18% në javën e kaluar. Norma mesatare e pozitivitetit ishte 17% (shtrirja: 0-50%).

Nga vendet që raportojnë për intensitetin e gripit, 1 vend ka raportuar për intensitet shumë të lartë, 2 për të lartë, 9 kanë raportuar intensitet mesatar, 14 të ulët dhe 5 kanë raportua intensitet bazë.

Nga vendet që raportojnë për shpërndarjen gjeografike, 15 kanë raportuar për shpërndarje të gjerë, 5 - rajonale, 7 - sporadike, 3 - lokale.

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve infektive
Instituti i Shëndetit Publik